



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi-Skupština-Assembly

# Doracak

EKSPERTIZA E JASHTME NË  
KOMISIONET PARLAMENTARE



Prishtinë, Tetor 2011





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi-Skupština-Assembly

# Doracak

EKSPERTIZA E JASHTME NË  
KOMISIONET PARLAMENTARE



Prishtinë, Tetor 2011



## Botimi i parë

### Anëtarët e grupit punues:

Xheladin Hoxha  
*Udhëheqës i Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare*

Istret Azemi  
*Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa*

Fatime Qorri  
*Koordinatore e Komisionit*

Armend Ademaj  
*Koordinator i Komisionit*

Vilson Ukaj  
*Koordinator i Komisionit*

Bardhyl Hasanpapaj  
*Drejtor i Institutit për Hulumtime Parlamentare (PRS)*

Rinor Beka  
*Menaxher i Programit Legjislativ të NDI*

Avni Zuka  
*Zyrtar i Programit Legjislativ të NDI*

Shefki Kastrati  
*Zyrtar i Programit Legjislativ të NDI*

*Publikimi i këtij doracaku është mundësuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI).*





## PËRMBAJTJA

HYRJE.....	5
1. ROLI I EKSPERTIZËS SË JASHTME NË PUNËN E PARLAMENTEVE.....	7
1.1. Shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme nga Kuvendi i Kosovës.....	8
1.2. Baza e të dhënave për ekspertët dhe institutet.....	9
1.3. Buxheti vjetor i komisioneve.....	10
2. PROCEDURAT PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE INDIVIDUAL.....	12
2.1. Identifikimi dhe përzgjedhja e ekspertëve individual.....	12
2.2. Përgatitja e termave të referencës.....	13
2.3. Përgatitja, dorëzimi dhe prezantimi i ekspertizës para komisionit.....	14
2.4. Procedurat për kryerjen e pagesës.....	15
2.5. Procedurat në rastet e bashkëfinancimit të ekspertëve individual.....	16
3. SHFRYTËZIMI I EKSPERTIZËS NGA INSTITUTET E SPECIALIZUARA.....	18
3.1. Natyra dhe lloji i shërbimeve që mund të sigurohen përmes instituteve të specializuara.....	19
3.2. Procedurat për angazhimin e instituteve të specializuara.....	20
3.3. Procedurat për bashkëfinancimin e instituteve/OJQ-ve.....	20
4. SHTOJCË.....	23
1. Udhëzim për administrimin e buxhetit të komisioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.....	25
2. Forma standarde e vendimit për angazhimin e ekspertëve.....	30
3. Forma standarde e termave të referencës.....	31
4. Forma standarde e letrës konfirmuese.....	33
5. Forma standarde e vendimit për angazhimin e ekspertëve–Bashkëfinancimi.....	34
6. Forma standarde e termave të referencës – Bashkëfinancimi.....	35
7. Forma standarde e letrës konfirmuese – Bashkëfinancimi.....	37
8. Forma standarde e planit vjetor të buxhetit të Komisionit.....	38



# Hyrje

Doracaku për “Shfrytëzimin e ekspertizës së jashtme nga komisionet parlamentare” ofron një pasqyrë të rregullave dhe praktikave më të mira për shfrytëzimin e ekspertizës së jashtme nga komisionet parlamentare. Përmes këtij doracaku, Departamenti Ligjor i Kuvendit në bashkëpunim me Divizionin për Buxhet dhe Pagesa synon të standardizoj dhe avancojë procedurat dhe praktikat aktuale të shfrytëzimit të buxhetit vjetor të komisioneve për sigurimin e ekspertizës së jashtme.

Doracaku në radhë të parë është i destinuar të shfrytëzohet si udhërrëfyes nga zyrtarët e Kuvendit përgjegjës për mbështetjen e komisioneve, zyrtarët e Divizionit për Buxhet dhe Pagesa të administratës së Kuvendit por edhe nga deputetët dhe veçanërisht nga kryetarët e komisioneve, të cilët e kanë rolin kryesor në mbarëvajtjen e punës në komisione.

Për më tepër doracaku mund të jetë i dobishëm edhe për organizatat e shoqërisë civile, institutet e specializuara, organizatat ndërkombëtare që mbështesin punën e Kuvendit si dhe ekspertët e pavarur, për të kuptuar më mirë procedurat e angazhimit të ekspertëve apo instituteve të specializuara pranë komisioneve parlamentare.

Doracaku është përgatitur nga grupi punues i përbërë nga zyrtarë të Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve, zyrtarë të Divizionit për Buxhet dhe Pagesa si dhe përfaqësues të Institutit Demokratik Kombëtar (NDI). Gjatë përgatitjes së doracakut grupi punues ka marrë parasysh Rregulloren e Kuvendit, Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit vjetor të Komisioneve, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregulloret e brendshme për menaxhimin e buxhetit të Kuvendit, si dhe praktikave më të mira aktuale për menaxhimin e buxhetit të komisioneve.

Në kapitullin e parë doracaku ofron një pasqyrë të qartë rreth rolit të ekspertizës së jashtme në punën e parlamentit si dhe përvojën dhe sfidat me të cilat është përballur Kuvendi i Kosovës në shfrytëzimin e ekspertizës së jashtme. Në kapitujt tjerë doracaku shpjegon qartë procedurat për angazhimin e ekspertëve individual dhe instituteve të specializuara, mënyrën e identifikimit dhe përzgjedhjes, marrëdhëniet kontraktuale, përgatitjen dhe dorëzimin e ekspertizës para komisionit, procedurat për kryerjen e pagesës si dhe procedurat e bashkëfinancimit. Në pjesën e dytë doracaku shtjellon praktikën dhe procedurat e angazhimit të instituteve të specializuara dhe OJQ-ve në punën e komisioneve parlamentare dhe natyrën e shërbimeve që ato mund të ofrojnë për komisionin.

Me qëllim të unifikimit të procedurave të punës në komisione, Departamenti Ligjor ka arritur t'i standardizojë përmbajtjen dhe strukturën e dokumenteve dhe formularëve të nevojshëm për



shfrytëzimin e ekspertizës së jashtme. Format standarde për këto dokumente i gjeni të bashkangjitura në këtë doracak.

Departamenti Ligjor do të vazhdojë të përgatis doracakë të ngjashëm edhe për aspekte të tjera të punës në Kuvend me qëllim që të rrisë efikasitetin e punës. Me këtë rast, falënderoj anëtarët e grupit punues për përkushtimin dhe angazhimin e tyre dhe njëherit shpreh mirënjohje për NDI dhe USAID që ka mbështetur përgatitjen dhe publikimin e doracakut.

**Daut Beqiri**

*Drejtor i Departamentit Ligjor  
Kuvendi i Republikës së Kosovës*



# 1. ROLI I EKSPERTIZËS SË JASHTME NË PUNËN E PARLAMENTEVE

Në të gjitha vendet me sistem parlamentar të qeverisjes, Qeveria e zgjedhur nga parlamenti harton politikat publike dhe përgatit pjesën dërmuese të legjislacionit të nevojshëm për implementimin e tyre. Në krahasim me organet legjislative, ato ekzekutive gjithmonë kanë në dispozicion resurse më të mëdha dhe mbështeten nga ekipe të specializuara ekspertësh në hartimin e politikave dhe projektligjeve. Megjithatë, në vendet me sistem demokratik të qeverisjes, Parlamenti ka fjalën e fundit në shqyrtimin, amendamentimin dhe miratimin e politikave dhe projektligjeve. Por, vetëm kompetencat e garantuara me Kushtetutë nuk mjaftojnë nëse nuk ndërtohen kapacitetet e nevojshme për ushtrimin efikas të tyre.

Parlamentet në përgjithësi, por veçanërisht në vendet në tranzicion, kanë në dispozicion resurse të brendshme të limituara, andaj kanë vështirësi për të ofruar mbështetjen e nevojshme teknike dhe profesionale që u nevojitet deputetëve për marrjen e vendimeve. Me qëllim të forcimit të rolit të parlamentit në këtë drejtim, në shumicën e parlamenteve të avancuara, ekzistojnë njësi që merren me hulumtime legjislative dhe ofrojnë ekspertizën e nevojshme për deputetët.

Edhe pse kanë numër të konsiderueshëm të punësuarish dhe resurse të gjera, këto njësi nuk kanë kapacitete të brendshme për të mbuluar të gjitha fushat apo çështjet që duhet ti shqyrtojë dhe miratojë parlamenti dhe njëkohësisht të ofrojë ekspertizë në çështje që mund të jenë specifike si psh, projektligjet mbi aviacionin civil, apo organizmat e modifikuar gjenetikisht, etj. Andaj, atyre u vihet në dispozicion një buxhet i caktuar vjetor që shërben për të angazhuar ekspertë të pavarur apo institute të specializuara që vihen në shërbim të deputetëve duke u ofruar atyre informacionet, analizat dhe rekomandimet që u nevojiten për të marrë vendimet e duhura.

Edhe pse secili deputet mbron dhe promovon pikëpamjet e subjektit të caktuar politik që përfaqëson dhe platformës me të cilën ka garuar në zgjedhje, ekspertiza e jashtme e ofruar nga ekspertë dhe institute të pavarura konsiderohet si shumë e dobishme në marrjen e vendimeve. Shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme ka rëndësi të madhe në punën e komisioneve parlamentare për së paku dy arsye. Së pari, vendimet e deputetëve të mbështetura në ekspertizën e jashtme profesionale ka më shumë gjasa të mos jenë të ndikuara nga qëndrimet politike dhe si rezultat mund të jenë më të justifikueshme dhe efektive. Së dyti, duke u bazuar në konkludimet dhe rekomandimet e ekspertëve, vendimet e deputetëve janë më të pranueshme nga qytetarët dhe gëzojnë shkallë më të lartë të zbatueshmërisë.

Përmes shfrytëzimit të ekspertizës së jashtme, parlamentet synojnë të sigurohen që gjatë procesit legjislativ janë marrë në konsideratë

pikëpamjet e të gjithë akterëve relevantë si dhe të përforcojnë pozicionin e tyre kushtetues, në mënyrë që të mos konsiderohen vetëm si institucione që thjeshtë “vulosin” politikat dhe projektligjet e dorëzuara nga Qeveria, por si institucione që mbrojnë dhe promovojnë interesin publik.

## *1.1. Shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme nga Kuvendi i Kosovës*

Që nga themelimi në vitin 2001, Kuvendi është mbështetur nga shumë institucione dhe organizata ndërkombëtare me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve që i nevojiten për të ushtruar me efikasitet funksionin përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës. Në fokus të asistencës së ofruar për Kuvendin, gjatë gjithë kësaj kohe, ka qenë Administrata e Kuvendit, e veçanërisht Departamenti Ligjor i cili luan rol qendror në ofrimin e mbështetjes së nevojshme teknike dhe profesionale për Kuvendin dhe organet e tij.

Pjesa më e rëndësishme e punës së Kuvendit, zhvillohet në komisionet parlamentare, të cilat shqyrtojnë në detaje politikat dhe projektligjet që i referohen nga Kuvendi varësisht, nga fushëveprimi i tyre, dhe më pas i dorëzojnë në Kuvend raportet me amendamente. Komisionet e Kuvendit të Kosovës, mbështeten në aspektin teknik dhe profesional vetëm nga Divizioni për Mbështetjen e Komisioneve, që funksionon në kuadër të Departamentit Ligjor dhe është ende në konsolidim e sipër.

Edhe pse është duke punuar në këtë drejtim, Kuvendi ende nuk ka arritur të themelojë një njësi të specializuar për hulumtime legjislativë që do të ndihmonte deputetët në punën e tyre. Madje, deputetët nuk kanë staf politik të angazhuar nga grupi parlamentar, dhe mjetet që ndahen nga “Fondi për Demokratizim” shfrytëzohen fare pak për angazhimin e ekspertëve pranë grupeve parlamentare.

Madje, deputetët nuk kanë zyrë apo asistent personal, andaj gjatë punës së tyre kryesisht gjejnë mbështetje tek zyrtarët e Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve. Por, për shkak të dinamikës së punës në komisionet parlamentare, numrit të kufizuar të zyrtarëve dhe çështjeve të shumta administrative dhe teknike, zyrtarët përgjegjës për mbështetjen e komisioneve janë shumë të ngarkuar.

Për më tepër, përvoja e deritanishme ka treguar se me gjithë resurset e gjera që Qeveria ka në dispozicion, deputetët shpesh janë ankuar për kualitetin e projektligjeve të dorëzuara për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Statistikat nga Departamenti Ligjor tregojnë se gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve në komisione, paraqitet nevoja për ndryshime dhe plotësime të shumta përmbajtësore. Kur marrim parasysh numrin e projektligjeve që dorëzohen çdo vit nga Qeveria (rreth 140 vetëm për vitin 2010) dhe kapacitetet aktuale të Kuvendit, ka qenë e domosdoshme që të krijohen mekanizma që do tu mundësonin komisioneve të shfrytëzojnë resurset e jashtme.

Praktika e shfrytëzimit të resurseve të jashtme gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve në komisionet e Kuvendit ka filluar vite më parë, dhe kryesisht me mbështetjen financiare nga organizatat që kanë ndihmuar punën e Kuvendit si: USAID, NDI, OSCE, AER, GTZ etj. Por, shfrytëzimi i ekspertëve të jashtëm vendorë dhe ndërkombëtarë është bërë në baza ad hoc dhe pa procedura apo rregulla të shkruara. Në mungesë të njësisë për hulumtime legjislative, që do të ofronte ekspertizë nga brenda dhe do të koordinonte ekspertizën e nevojshme nga jashtë, barra e shfrytëzimit të resurseve të jashtme ka rënë mbi Divizionin për Mbështetjen e Komisioneve.

Në përpjekje për të lehtësuar procesin e angazhimit të ekspertëve të jashtëm, vitin 2008, me asistencën e ofruar nga NDI, zyrtarët e Divizionit për Mbështetjen e Komisioneve kanë arritur të përgatisin një bazë të dhënash për ekspertë dhe institute të specializuara. Më pas, në vitin 2009, duke u bazuar në planin strategjik të Kuvendit të miratuar në dhjetor të vitit 2008, Kuvendi vendosi të ndaj një buxhet të veçantë për secilin komision parlamentar. Meqenëse, pjesa më e madhe e buxhetit të komisioneve përdoret për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, Kryesia e Kuvendit kishte nxjerrë një vendim që rregullonte nivelin dhe mënyrën e pagesës së ekspertëve të jashtëm, por që nuk rezultoi të ishte i mjaftueshëm dhe efikas në praktikë.

Andaj, në mungesë të një udhëzimi të brendshëm për menaxhimin e buxhetit vjetor të komisioneve dhe në mungesë të informacioneve e udhëzimeve adekuate, deri më tani komisionet në përgjithësi nuk kanë arritur të shfrytëzojnë me efikasitet mjetet e vëna në dispozicion. Si pasojë, gjatë rishikimit të buxhetit në muajin qershor të vitit 2010, është vendosur që buxheti i komisioneve të zvogëlohet për 50%.

Për të adresuar këtë problem, në vitin 2011, Kryesia e Kuvendit miratoi Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit Vjetor nga Komisionet Parlamentare. Me këtë udhëzim janë definuar në mënyrë specifike aktivitetet për të cilat komisioni mund të shfrytëzoj mjetet, procedurat e miratimit dhe ekzekutimit të shpenzimeve, roli i kryetarit dhe koordinatorit të komisionit, dokumentacioni përkatës për arsyetimin e shpenzimeve si dhe roli e përgjegjësitë e organeve relevante të administratës së Kuvendit në administrimin e buxhetit. Praktikisht, udhëzimi është treguar më i përshtatshëm dhe ka ndihmuar Komisionet që të jenë më efikas në shfrytëzimin e ekspertizës jashtme.

## *1.2. Baza e të dhënave për ekspertët dhe institutet*

Në funksion të rritjes së efikasitetit të punës së Komisioneve parlamentare, Divizioni për Mbështetjen e Komisioneve gjatë vitit 2009 mori iniciativën për krijimin e një baze të dhënash për ekspertë dhe institute të specializuara. Baza e të dhënave për ekspertët është konsideruar e domosdoshme për faktin se komisioneve parlamentare



u ofron të dhëna mbi ekspertët individual dhe institutet e specializuara në çështjet që mbulon komisioni në kuadër të fushëveprimtarisë së tij.

Baza e të dhënave është zhvilluar në bashkëpunim me Institutin Demokratik Kombëtar (NDI), që për një kohë të gjatë ka mbështetur punën e komisioneve me ekspertë të jashtëm kryesisht vendorë, në procesin e shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve në komisione. Divizioni për Mbështetjen e Komisioneve synonte që në kuadër të bazës së të dhënave të përfshihen emra të njohur të jetës akademike në vend, ekspertë të fushave të ndryshme që kanë specializuar jashtë vendit si dhe institute të specializuara që mund të ofrojnë ekspertizë për komisionet parlamentare.

Për përgatitjen e bazës së të dhënave, është publikuar një njoftim publik përmes të cilit janë ftuar ekspertët e fushave të ndryshme që të dërgojnë rezymetë e tyre por që njëkohësisht, janë kontaktuar institutet vendore, universitetet e akredituara, institucionet rajonale dhe ndërkombëtare në vend me qëllim të mbledhjes së të dhënave për ekspertët dhe institutet. Si rezultat i këtij procesi, në kuadër të bazës së të dhënave fillimisht janë përfshirë rreth 300 ekspertë individual dhe mbi 230 Institute dhe OJQ të specializuara në fusha të ndryshme. Baza e të dhënave është përgatitur si softver në Microsoft Access. Kategorizimi i ekspertëve është bërë sipas fushëveprimtarisë që mbulojnë komisionet.

Me qëllim të thjetëzimit të procedurave për angazhimin e ekspertëve të jashtëm dhe rritjes së efikasitetit të punës, Kryesia e Kuvendit ka vendosur që baza e të dhënave për ekspertët të konsiderohet si listë zyrtare, nga e cila pastaj komisionet mund të angazhojnë ekspertë për kohë të shkurtër me procedurë shumë të thjeshtë.

Sipas nenit 4 të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve, në fillim të secilit vit, komisionet e azhurnojnë bazën e të dhënave për ekspertë, me ç'rast zyrtarët që mbështesin punën e komisionit dhe deputetët propozojnë që emra të rinj të ekspertëve individual dhe instituteve të specializuara të bëhen pjesë e bazës së të dhënave. Nëse gjatë mandatit, anëtarët e komisionit propozojnë ekspertë të rinj potencial që kanë kualifikimin e duhur për të ofruar ekspertizën që i nevojitet komisionit, por që nuk janë në listën e ekspertëve, atëherë me vendim të komisionit, koordinatori sigurohet që ta përfshijë në bazën e të dhënave. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave janë përgjegjësi e koordinatorit të komisionit.

### *1.3. Buxheti vjetor i komisioneve*

Me qëllim që tu ndihmohet në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi me efikasitet më të lartë, në vitin 2009 Kuvendi vendosi që komisioneve kryesore tu ndahen nga 20.000 Euro në vit, ndërkaq atyre funksionale nga 10.000 Euro. Buxheti i komisionit menaxhohet nga kryetari i

komisionit në bashkëpunim të ngushtë me zëvendëskryetarët dhe koordinatorin e komisionit. Shpenzimet kryesore buxhetore duhet të parashikohen në planin vjetor të punës, që komisioni e miraton në fillim të vitit, por që rishikohen në baza periodike me qëllim që tu përshtaten nevojave të komisionit.

Buxheti që u ndahet komisioneve parlamentare është dedikuar kryesisht për angazhimin e ekspertëve për kohë të shkurtër, organizimin e dëgjimeve publike, organizimin e vizitave në institucionet shtetërore e publike, bashkëfinancimin e projekteve që ndërlidhen me aktivitetet dhe detyrat e komisionit, përgatitjen dhe botimin e buletinit informativ periodik dhe publikimeve të ndryshme që ndërlidhen me punën e komisionit.

Buxheti i komisioneve menaxhohet, duke u bazuar në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit vjetor të komisioneve parlamentare, të miratuar nga Kryesia e Kuvendit. Vendimi për të shpenzuar buxhetin në çështje të caktuara mund të merret vetëm nga komisioni me shumicë votash, pas shqyrtimit të propozimeve që vijnë nga kryetari apo ndonjëri nga anëtarët e komisionit. Kryetari i komisionit mund të lejoj pagesat, në bazë të planit vjetor financiar, deri në shumën prej 100 (njëqind) euro, pa vendim të komisionit.

Koordinatori i komisionit është i autorizuar për të kryer të gjitha çështjet procedurale që ndërlidhen me ekzekutimin e buxhetit në bashkëpunim me Divizionin për Buxhet dhe Pagesa të Kuvendit. Koordinatori i Komisionit në baza tremujore e njofton me shkrim Divizionin për Buxhet dhe Pagesa për shpenzimet e buxhetit vjetor të komisionit. Të gjitha dokumentet për shpenzimet e buxhetit të komisionit nënshkruhen nga kryetari i komisionit.

## 2. PROCEDURAT PËR ANGAZHIMIN E EKSPERTËVE INDIVIDUAL

Komisionet parlamentare kanë në dispozicion një sërë resurcesh të jashtme prej nga mund të sigurojnë ekspertizën e nevojshme gjatë shqyrtimit të projektligjeve, mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve apo shqyrtimit të politikave qeveritare. Institutet e specializuara, organizatat e shoqërisë civile, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në vend dhe ekspertët e pavarur nga vendi dhe rajoni janë disa nga resurset kryesore që komisionet mund të shfrytëzojnë për të siguruar ekspertizën e nevojshme.

Praktika e deritanishme ka treguar se angazhimi i ekspertëve individual nga komisionet parlamentare është treguar proceduralisht i lehtë dhe njëkohësisht efikas. Baza aktuale e të dhënave për ekspertët dhe OJQ-të, përmban një numër të konsiderueshëm të të dhënave për ekspertë individual të fushave të ndryshme. Edhe procedurat e angazhimit të ekspertëve individual dhe aspektet kontraktuale, sidomos ato që ndërlidhen me afatet kohore janë treguar të përshtatshme për natyrën e punës në komisione. Natyrisht, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton që bashkëpunimi me institutet e specializuara dhe organizatat e shoqërisë civile nuk është treguar efikas.

### 2.1. Identifikimi dhe përzgjedhja e ekspertëve individual

Duke u bazuar në planin vjetor të punës dhe numrin e projektligjeve që i referohen nga Kuvendi, komisioni përcakton agjendën dhe projektligjet që do të kenë prioritet në procesin e shqyrtimit dhe amendamentimit. Varësisht nga rëndësia dhe kompleksiteti i çështjeve që mbulon një projektligj, komisioni vendos se për cilat projektligje do të ketë nevojë të angazhojë ekspertë të jashtëm. Me gjithë faktin se komisioni mund të organizojë dëgjime publike apo vizita në terren, angazhimi i ekspertëve të pavarur i ofron komisionit një pasqyrë më të qartë të çështjeve diskutabile dhe ndihmon deputetët në marrjen e vendimeve.

Pasi të jetë vendosur se për cilin projektligj do të angazhohet eksperti i jashtëm, dhe për cilat aspekte të projektligjit kërkohet ekspertizë, fillon procesi i përzgjedhjes. Duke i'u referuar bazës së të dhënave, koordinatori i komisionit në bashkëpunim me Kryetarin e Komisionit apo Kryesuesin e Grupit Punues, identifikon 3 deri në 5 kandidatë që konsiderojnë se kanë përgatitjen e nevojshme akademike dhe profesionale për tu angazhuar si ekspertë për projektligjin në fjalë.

Lista e ngushtë e kandidatëve vendoset në rend të ditës për takimin e radhës së komisionit, ndërkohë që koordinatori i komisionit shpjegon kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për listën e ngushtë. Anëtarët e

komisionit shqyrtojnë përgatitjen e tyre akademike dhe profesionale dhe me shumicë votash vendosin për kandidatën që do t'i bëhet oferta. Për të evituar vonesat dhe përsëritjen e procedurës së përzgjedhjes në rast se kandidati i parë nuk pranon ofertën, komisioni përzgjedh edhe kandidatën e dytë, si kandidat potencial.

Shuma për kompensimin e ekspertëve përcaktohet nga Komisioni me rastin e marrjes së vendimit për angazhimin e ekspertëve, në vartësi nga vëllimi dhe përmbajtja e lëndës. Kompensimi financiar, për shërbimet që eksperti ia ofron Komisionit, bëhet në bazë të ditëve të punës të përcaktuar në nenet 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Kryetari i komisionit duhet të synojë që vendimi për përzgjedhjen e ekspertëve të bëhet me konsensusin e të gjithë anëtarëve të komisionit. Në rast të mospajtimeve në mes të anëtarëve të komisionit, përzgjedhja e ekspertëve bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për angazhimin e ekspertit nënshkruhet nga Kryetari i komisionit. Procesi i identifikimit dhe përzgjedhjes së ekspertëve është mjaft i ndjeshëm dhe duhet të jetë sa më transparent me qëllim të evitimit të situatave kur të gjeturat dhe rekomandimet e tyre konsiderohen të ndikuara politikisht.

## *2.2. Përgatitja e termave të referencës*

Në momentin kur vendoset për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, anëtarët e komisionit theksojnë aspektet kryesore të projektligjit në të cilat duhet të përqendrohet ekspertiza. Njëkohësisht, komisioni vendos edhe për kohëzgjatjen e angazhimit të ekspertit si dhe aspektet e implikimeve financiare. Koordinator i komisionit në bashkëpunim me grupin punues për projektligjin përgatit termat e referencës, ku përshtohen detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit, afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në komision si dhe shuma dhe mënyra e pagesës.

Në përputhje me vendimin e Komisionit, koordinatori i komisionit e kontakton ekspertin në fjalë për tu siguruar nëse e pranon në parim ofertën për të ofruar shërbimet e tij pranë komisionit. Nëse për çfarëdo arsye, i përzgjedhuri i parë (eksperti) nuk pranon ofertën e komisionit, atëherë koordinatori kontakton të përzgjedhurin e dytë (kandidatën potencial) të zgjedhur nga komisioni. Koordinator duhet të demonstrojë aftësi të mira të negociimit dhe të sigurohet që vërejtjet dhe sugjerimet eventuale të ekspertit të merren parasysh por që të mos tejkalojnë shumën e kompensimit financiar.

Nëse eksperti pranon përshtkrimin e detyrave dhe përgjegjësiave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve pranë komisionit, koordinatori mund të propozojë menjëherë nënshkrimin e termave të



referencës. Kryetari i komisionit nënshkruan në emër të komisionit. Pas nënshkrimit të termave të referencës koordinatori duhet të kërkoj nga eksperti që të ofrojë një kopje të dokumentit të identifikimit dhe llogarinë bankare. Një kopje e termave të referencës mbahet në komision, një kopje e mban eksperti ndërsa një kopje i dërgohet Divizionit për Buxhet dhe Pagesa të Kuvendit.

Termet e referencës për angazhimin e ekspertëve të jashtëm konsiderohen si dokument standard i miratuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit. Në rastet kur për shkak të natyrës së ekspertizës kërkohen aranzhime specifike që nuk mbulohen nga dispozitat e formës standarde, atëherë koordinatori i komisionit është i obliguar që të konsultohet me Komisionin dhe të kërkoj miratimin e tij, para nënshkrimit të termave të referencës.

### *2.3. Përgatitja, dorëzimi dhe prezantimi i ekspertizës para komisionit*

Në kuadër të termave të referencës ndër të tjera duhet definuar qartë kornizën e ekspertizës si dhe produktin final i cili duhet të dorëzohet dhe të prezantohet para komisionit. Termet e referencës specifikojnë qartë afatin kohor brenda të cilit ekspertiza duhet të dorëzohet në komision. Gjatë përgatitjes së ekspertizës, koordinatori i komisionit duhet të sigurohet që të gjitha dokumentet relevante të vihen në dispozicion të ekspertit.

Eksperti nuk është i obliguar të marrë pjesë në takimet e komisionit, por nëse e konsideron të nevojshme, i mundësohet të marrë pjesë në takimet e komisionit apo grupeve punuese, kur këto të fundit shqyrtojnë projektligjin për të cilin është angazhuar eksperti. Ekspertit i mundësohet të marrë pjesë edhe në dëgjimet e komisionit apo vizitat në terren të cilat organizohen nga komisioni me qëllim të mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave për projektligjin në shqyrtim.

Pasi ta ketë kompletuar ekspertizën, në kuadër të afatit të përcaktuar me termet e referencës, eksperti e dorëzon dokumentin final tek koordinatori i komisionit. Koordinatorin e njofton grupin punues për projektligjin, dhe më pas dakordohen që ekspertiza të përfshihet në rendin e ditës për një nga mbledhjet e ardhshme. Pasi të kenë vendosur për datën e mbledhjes së grupit punues, kur do të prezantohet ekspertiza, koordinatori e njofton me shkrim ekspertin.

Eksperti është i obliguar që në datën e caktuar nga grupi punues, të prezantoj të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të përfshira në kuadër të dokumentit final të dorëzuar paraprakisht tek koordinatori. Anëtarët e grupit punues mund të parashirojnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime shtesë rreth observimeve (vërejtjeve) dhe rekomandimeve konkrete të ofruara nga eksperti. Kjo me qëllim të sqarimit të dilemave dhe



paqartësive eventuale që mund të ndikojnë në procesin vendimmarrës gjatë përgatitjes së raportit final me amendamente. Me kërkesë të grupit punues, ekspertit mund ti kërkohej të prezantojë të gjeturat dhe rekomandimet e tij edhe para komisionit.

Më pas, në takimet e radhës, komisioni shqyrton edhe një herë rekomandimet konkrete të ofruara nga eksperti dhe vendosë se cilat rekomandime mund të shndërrohen në amendamente. Numri i rekomandimeve të ekspertit, që komisioni vendos ti përfshijë si amendamente specifike në raportin final që dorëzohet për shqyrtim të dytë, është indikator i rëndësishëm i cilësisë së ekspertizës. Një kopje e dokumentit final të ekspertizës mbetet në dosjet e komisionit, ndërkohë që një kopje dërgohet në bibliotekën e Kuvendit.

## 2.4. Procedurat për kryerjen e pagesës

Pas dorëzimit dhe prezantimit të ekspertizës në komision, Kryetari i Komisionit në bashkëpunim me koordinatorin bëjnë një vlerësim të përgjithshëm rreth respektimit të termave të referencës nga ana e ekspertit dhe cilësisë së produktit final të dorëzuar në komision. Më pas, Kryetari në emër të komisionit lëshon një letër konfirmuese për Divizionin për Buxhet dhe Pagesa, përmes së cilës vërteton se eksperti ka përmbushur obligimet e përcaktuara në termat e referencës dhe se pagesa mund të ekzekutohet. Si dëshmi, letrës konfirmuese i bashkëngjitet dokumenti final i ekspertizës së dorëzuar në komision.

### *Dokumentet që koordinatori i komisionit duhet t'i dorëzoj në Divizionin për Buxhet dhe Pagesa janë:*

- 1. vendimi i komisionit për angazhimin e ekspertit;*
- 2. termat e referencës;*
- 3. letra konfirmuese për përfundimin e ekspertizës; dhe*
- 4. një kopje të ekspertizës të dorëzuar në komision, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga eksperti.*

Shuma e tërësishme e mjeteve të miratuara nga komisioni për ekspertizë ekzekutohet përmes Divizionit për Buxhet dhe Pagesa, brenda afatit ligjor nga dorëzimi i letrës autorizuese. Meqë ekspertiza e kërkuar nga Komisioni përkatës është shërbim që i ofrohet Kuvendit, atëherë Kuvendi nuk do të marrë përsipër që të paguaj asnjë lloj tatimi në këtë drejtim, për kryerjen e obligimeve tatimore do të jetë përgjegjës eksperti i angazhuar. Divizioni për buxhet obligohet që të njoftojë koordinatorin e komisionit për ekzekutimin e pagesës.

Pas përmbylljes së ciklit të një ekspertize, koordinatori mbledh të gjitha dokumentet relevante me ekspertizën dhe i vendos në një dosje



të veçantë të komisionit për angazhimin e ekspertëve të jashtëm. Në fund, koordinatori sigurohet që edhe në bazën e të dhënave të figurojnë informacione që tregojnë se eksperti në fjalë, ka qenë i angazhuar në komision dhe ndonjë të dhënë shtesë rreth kualitetit të ekspertizës.

## *2.5. Procedurat në rastet e bashkëfinancimit të ekspertëve individual*

Që nga themelimi i Kuvendit në vitin 2001, komisionet vazhdimisht janë mbështetur nga institucione dhe organizata ndërkombëtare të cilat janë angazhuar për ngritjen e kapaciteteve për analizimin dhe amendamentimin e projektligjeve në komisione. Meqenëse, buxheti që komisionet kanë në dispozicion për të angazhuar ekspertë është i kufizuar, bashkëfinancimi i ekspertëve mund të jetë një nga alternativat.

Andaj, në fillim të secilit vit kalendarik Kryetari i Komisionit dhe koordinatori zhvillojnë takime të ndara me organizatat dhe institucionet që mbështesin punën e komisionit për të shqyrtuar mundësinë e bashkëfinancimit të ekspertëve të jashtëm. Komisioni mund të nënshkruaj edhe memorandume bashkëpunimi ku definohet mbështetja konkrete që do ti ofrohet komisionit për angazhimin e ekspertëve të jashtëm. Në fund të këtij procesi, komisioni do të ketë një vlerësim të përafërt të asistencës financiare që do të ofrohet nga këto organizata gjatë vitit, e që pastaj do të reflektohet edhe në planin vjetor të punës.

Komisioni sigurohet që në kuadër të listës së projektligjeve për të cilët synon të angazhojë ekspertë të jashtëm, të identifikoj partnerët potencial për bashkëfinancim, varësisht nga fushëveprimtaria dhe interesi i këtyre të fundit. Komisioni mund të vendosë për përqindjen minimale që duhet të mbulojnë organizatat partnere në rastet e bashkëfinancimit, ndërkohë që përqindja definitive e mjeteve dhe obligimet e palëve përcaktohen ndaras në secilin rast.

Gjatë identifikimit dhe përzgjedhjes së ekspertëve në rastet e bashkëfinancimit organizata apo institucioni bashkëfinancues si palë e tretë merr pjesë aktivisht, dhe jep rekomandime për kandidatët potencial për ekspertë. Në këto raste synohet të arrihet konsensus në mes të qëndrimit të komisionit dhe pikëpamjeve apo preferencave të organizatës mbështetëse.

Pala e tretë (bashkëfinancuesi) ka rol aktiv në përgatitjen e detyrave dhe përgjegjësive të ekspertit dhe definimin e termave të referencës, përmes së cilës definohen përgjegjësitë e tri palëve. Në rastet e bashkëfinancimit termat e referencës nënshkruhen nga të tri palët: kryetari i komisionit, eksperti dhe pala bashkëfinancuese. Koordinator i komisionit e menaxhon tërë procesin dhe sigurohet që të gjitha palët të kenë nga një kopje të dokumentacionit, ndërkohë që një kopje i dërgohet edhe Divizionit për Buxhet dhe Pagesa.

Procesi i përgatitjes, dorëzimit dhe mbrojtjes së ekspertizës në rastet e bashkëfinancimit është i njëjtë sikur në rastet e financimit të plotë nga ana e komisionit, me përjashtim të faktit se pala e tretë (bashkëfinancuesi) vazhdimisht informohet për ecurinë e procesit dhe ftohet të marrë pjesë në takimet e grupit punues apo komisionit ku prezantohet ekspertiza. Procedurat për financimin e pjesës që mbulohet nga Organizatat/Institucionet partnere, mund të përcaktohen edhe në Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Kuvendin, dhe jo domosdoshmërisht i nënshtrohen procedurave të përcaktuara në Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Koordinatori i komisionit sigurohet që të gjitha dokumentet relevante me ekspertizën të vendosen në dosje të veçantë dhe i dërgohen të gjitha palëve. Në fund të procesit, Kryetari në emër të komisionit i dërgon një letër zyrtare organizatës partnere përmes së cilës e falënderon për mbështetjen financiare të ofruar me rastin e bashkëfinancimit të ekspertit.

### 3. SHFRYTËZIMI I EKSPERTIZËS NGA INSTITUTET E SPECIALIZUARA

Parlamentet e vendeve perëndimore çdo herë e më shumë tentojnë të sigurojnë shërbime përmes instituteve të specializuara. Kjo tendencë është në rritje e sipër edhe në Kuvendin e Kosovës. Në këtë kuadër, sigurimi i shërbimeve të instituteve vendore përbën një risi për Kuvendin e Kosovës dhe duhet të konsiderohet si mundësi e mirë për të rritur efikasitetin e punës.

Shërbimet nga institucionet jo-qeveritare, ofrohen kryesisht nëpërmjet dy lloj iniciativash: ato të shoqërisë civile dhe ato krejtësisht private. Dallimi kryesor, e që është i rëndësishëm për këtë doracak, ka të bëjë me natyrën e institucioneve jo-qeveritare në përcaktimin si “profitabile” dhe “jo-profitabile”. Në këtë doracak, rëndësi më e madhe u është dhënë instituteve të specializuara që janë jo-profitabile dhe që i përkasin sektorit të shoqërisë civile. Këto institute qëllimin kryesor nuk e kanë përfitimin, por krijimin dhe promovimin e një morie vlerash në dobi të shoqërisë. Në këtë rast, identifikimi i iniciativave jo-qeveritare, që kanë zhvilluar dhe avancuar profilizimin e tyre në atë masë sa, përmes ekspertizës së tyre mund të kenë ndikim në politikë-bërje dhe vendim-marrje. Përmes angazhimit të instituteve profesionale vendore, Kuvendi i Kosovës mund të arrijë dy qëllime kryesore: të rrisë efikasitetin e punës si dhe në të njëjtën kohë të rrisë transparencën e procesit të vendim-marrjes dhe shqyrtimit të legjislacionit nga Kuvendi.

Institutet zakonisht punojnë jo vetëm për të kryer shërbimin e siguruar por edhe për të promovuar veten dhe cilësinë e shërbimit që ato janë në gjendje të ofrojnë. Për më tepër, duke njohur edhe më mirë punën e Kuvendit dhe duke punuar me deputetët, institutet do kenë edhe mundësinë që ta promovojnë punën e Kuvendit, duke e ngrit imazhin e tij në raport me publikun.

Në shumicën e rasteve mund të sigurohen shërbime dhe ekspertiza profesionale nga këto institute pa kosto buxhetore ose me kosto shumë të ulët, por vetëm përmes partneritetit dhe ndërtimit të besimit të ndërsjellë. Në vitet e fundit, Kuvendi i Kosovës ka filluar të shfrytëzojë gjithnjë e më shumë këtë praktikë, me ç’rast ka arritur të siguroj më shumë informata nga këndvështrime të ndryshme gjatë procesit legjislativ.

Një mënyrë tjetër e sigurimit të ekspertizave profesionale është nëpërmjet angazhimit të instituteve të specializuara nga komisionet parlamentare, të cilat konsiderojnë se mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së projektligjeve në shqyrtim. Këto institute mund të jenë persona juridik të regjistruar, që kanë kapacitete adekuate profesionale në fusha specifike dhe mund të vihen në shërbim të komisioneve parlamentare.

Shërbimet e tyre mund të sigurohen në formë të konsulencës nëpërmjet marrëveshjeve të shkruara apo kontratës.

Për më tepër ndërtimi i partneriteteve me këto institute, përveç në fazën e amendamentimit është i dobishëm edhe në fazat e më vonshme kur ligji fillon zbatimin. Meqë puna e këtyre organizatave apo instituteve është e përqendruar në terren, ato mund t'i sigurojnë informata të dobishme për të identifikuar ngeçjet e mundshme në zbatim, dhe të ndihmojnë komisionet në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës.

### *3.1. Natyra dhe lloji i shërbimeve që mund të sigurohen përmes instituteve të specializuara*

Përkushtimi i parlamenteve për të aprovuar ligje sa më cilësore dhe që janë të zbatueshme në praktikë ka shtruar nevojën për të siguruar ekspertiza sa më profesionale dhe kredibile, që shpesh mund të ofrohen vetëm nga institute të specializuara. Identifikimi dhe kategorizimi i këtyre instituteve është faza e parë për të cilin duhet të angazhohen Komisionet parlamentare. Në grupin e këtyre instituteve hyjnë organizatat që kanë kapacitete dhe kuadro profesionale që mund të ofrojnë ekspertiza specifike dhe profesionale në fusha të caktuara. Pra, ato zakonisht janë të profilizuara dhe konsiderohen kompetente brenda fushëveprimtarisë së tyre.

Çdo komision, duhet të përfshijë në kuadër të bazës së të dhënave për ekspertë, të gjitha institutet dhe organizatat jo qeveritare të specializuara në fushën që mbulon komisioni. Kryetari i Komisionit dhe veçanërisht zyrtarët e komisionit duhet të sigurohen që të ndërtojnë raporte të mira me këto subjekte, me qëllim të shfrytëzimit të shërbimeve të tyre gjatë shqyrtimit të projektligjeve si dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve në praktikë.

Siç është përmendur edhe më lartë në këtë doracak, natyra e ekspertizës që kërkohet në komisionet e Kuvendit është shumë specifike dhe kërkon burime njerëzore të specializuara në fushën përkatëse. Meqenëse identifikimi i ekspertëve individual shpesh nuk është i lehtë, angazhimi i instituteve të specializuara mund të sigurojë ekspertizën në një kohë shumë më të shpejtë.

Komisionet mund të angazhojnë Institutet për të ofruar:

- hulumtime dhe analiza të politikave;
- analiza financiare, përfshirë vlerësime të ndikimit financiar të projektligjeve;
- hulumtime për të ndihmuar në monitorimin e zbatimit të ligjeve;
- hartim të dispozitave ligjore dhe amendamenteve për projektligje;
- këshillime ligjore dhe analiza ligjore;
- hulumtime për harmonizim të ligjeve me legjislacionin e BE-së;
- takime informimi për temat e politikave që kanë të bëjnë me agjendën legjislative të Kuvendit, etj.

Këto shërbime mund të sigurohen nga komisionet, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me institutet e specializuara. Për këtë qëllim mund të shfrytëzohen mjetet nga buxheti i ndarë për nevoja të komisioneve parlamentare si dhe duke ndjekur procedurat e përcaktuara me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

### *3.2. Procedurat për Angazhimin e Instituteve të Specializuara*

Procedurat për angazhimin e instituteve të specializuara nuk janë shumë të ndryshme nga ato për ekspertët individual, e përshkruar dhe shpjeguar më lartë. I vetmi dallim që ekziston ka të bëjë me palën kontraktuese. Në këtë rast, palë kontraktuese nuk është më personi fizik por ai juridik. Institutet janë kryesisht të regjistruara si persona juridik dhe veprojnë si të tillë. Përfitimi kryesor në rastin e sigurimit të shërbimeve nga Institutet ka të bëjë me cilësinë dhe 'sasinë' e shërbimit që ofrohet. Në rastin e sigurimit të shërbimeve nga ana e ekspertëve individual, maksimumi që mund të ofrohet është maksimumi i dijes, shkathtësive dhe vet punës që ka kapacitet ai person për të ofruar.

### *3.3. Procedurat për bashkëfinancimin e instituteve/OJQ-ve*

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe krijimit të formave standarde, edhe procedurat e bashkëfinancimit të instituteve/OJQ-ve nuk dallojnë shumë nga procedurat e angazhimit të vetëfinancuar nga Komisionet. Tashmë Kuvendi i Kosovës ka ndërtuar partneritete të qëndrueshme me organizata, kryesisht ndërkombëtare që janë të gatshme të ndihmojnë Kuvendin dhe komisionet parlamentare për të përmbushur me efikasitet detyrat dhe përgjegjësitë kushtetuese. Në kuadër të programeve të tyre, këto organizata përveç që ofrojnë mbështetje nëpërmjet stafit të angazhuar, kanë paraparë edhe mbështetjen përmes bashkëfinancimit. Kushtet dhe mënyrat e bashkëfinancimit, duke përfshirë përqindjen e kostos së shërbimeve që mbulojnë duhet të jenë pjesë e marrëveshjes ndërmjet Komisioneve dhe organizatave që janë të gatshme për bashkëfinancim, gjithmonë duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Me synimin për të rritur efikasitetin e punës së komisioneve, Kryetari i Komisionit dhe koordinatori në çdo fillim vit duhet të organizojë takim të përbashkët me organizata partnere. Qëllimi i këtij takimi duhet të jetë diskutimi dhe gjetja e mënyrave të bashkëpunimit, koordinimit më të mirë të mbështetjes së tyre si dhe mundësitë e këtyre organizatave që të marrin pjesë në bashkëfinancim të shërbimeve që mund ti duhen Komisionit nga institutet e specializuara. Një dakordim paraprak do ti ndihmonte Komisioneve që më lehtë të përgatisin Planin vjetor të shpenzimit të buxhetit të Komisioneve.

Edhe procesi i përzgjedhjes së instituteve që duhet të angazhohen është i ngjashëm me procesin e përzgjedhjes së ekspertëve individual nëpërmes bashkëfinancimit. Vendimi përfundimtar për përzgjedhjen i takon Komisionit, por edhe organizata që merr pjesë në bashkëfinancim duhet që gjatë procesit të përzgjedhjes të jetë e përfshirë aktivisht, ashtu sikur që duhet të jetë pjesë aktive edhe gjatë procesit të caktimit të termave të referencës për organizatën apo institutin që angazhohet.

Ndërkaq, koordinatori i komisionit është përgjegjës për respektimin e procedurave administrative të parapara me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare. Përfshirja nga kjo mund të bëjë vetëm pjesë e procedurave që përfshinë pagesën nga organizata partnere që jo domosdoshmërisht respekton procedurat e Kuvendit.





## 4. Shtojcë



1. Udhëzim për administrimin e buxhetit të komisioneve të  
Kuvendit të Republikës së Kosovës



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

UDHËZIM

PËR ADMINISTRIMIN E BUXHETIT TË KOMISIONEVE TË  
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, prill 2011

Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 15, nenit 62.3 dhe nenit 65.3 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2011, nxjerr:

## **Udhëzim**

### **për administrimin e buxhetit të komisioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Më këtë Udhëzim përcaktohet mënyra e administrimit të buxhetit vjetor të komisioneve të Kuvendit të Republikës së Kosovës (tutje Komisioni).

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Udhëzimi përcakton procedurat për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore nga komisionet parlamentare për aktivitetet në vijim:

- a) Ekspertizat e jashtme,
- b) Dëgjimet e komisionit,
- c) Aktivitetet mbikëqyrëse të komisionit,
- ç) Grupet punuese, kur punojnë jashtë selisë së Kuvendit (brenda vendit) dhe
- d) Marrëdhëniet ndërparlamentare.

#### **Neni 3 Planifikimi dhe administrimi i buxhetit nga komisioni**

1. Komisioni, në fillim të çdo viti kalendarik, pas miratimit të Ligjit vjetor për Buxhetin dhe pas miratimit të planit vjetor të punës, harton planin vjetor financiar, për financimin e aktiviteteve nga buxheti i komisionit.
2. Plani vjetor financiar për shfrytëzimin e buxhetit dhe çdo ndryshim e plotësim, miratohet nga komisioni.
3. Buxhetin e komisionit e administrojnë kryetari i Komisionit, në bashkëpunim me zëvendëskryetarët dhe koordinatoren e komisionit.
4. Kryetari i Komisionit mund të lejoj pagesat, në bazë të planit vjetor financiar, deri në shumën deri në 100 (njëqind) euro, pa vendim të komisionit. Shuma e tërësishme, e paguar në këtë mënyrë, nuk mund ta kalojë shumën mbi 500 (pesëqind) euro, brenda vitit kalendarik. Të gjitha pagesat mbi 100 (njëqind) euro, bëhen me vendim të komisionit.



5. Të gjitha pagesat bëhen me transfer bankar nga Divizioni për Buxhet dhe Pagesa.
6. Koordinator i Komisionit në baza tremujore e njofton me shkrim Divizionin për Buxhet dhe Pagesa për shpenzimet e buxhetit vjetor të komisionit.
7. Të gjitha dokumentet për shpenzimet e buxhetit të komisionit nënshkruhen nga kryetari i Komisionit.

#### **Neni 4. Ekspertizat ligjore**

1. Në fillim të vitit, komisioni, mund të shqyrton dhe azhurnon listën ekzistuese të ekspertëve. Për një çështje të caktuar, kur komisioni konsideron se është e domosdoshme të angazhohet një ekspert që nuk është në listën zyrtare të ekspertëve, vendimi duhet të merret më shumicën e votave të anëtarëve prezent.
2. Grupi punues i Komisionit në bashkëpunim me Koordinatorin e Komisionit dhe në konsultim me kryetarin e Komisionit, duke iu referuar listës zyrtare të ekspertëve, identifikon tre (3) deri pesë (5) ekspertë të fushës dhe ia paraqet komisionit për përzgjedhje. Komisioni vendos për përzgjedhjen e dy kandidatëve potencial, në mënyrë që t'i evitohet vonesat në rastet kur kandidati i parë në radhë, nuk pajtohet me kushtet e angazhimit.
3. Koordinator i Komisionit në bashkëpunim me grupin punues dhe kryetarin e Komisionit përgatishin termat e referencës (përshkrimi i detyrave). Termat e referencës definojnë objektin e ekspertizës, detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në komision. Termat e referencës i dorëzohen ekspertit dhe pas nënshkrimit, konsiderohen të pranuar. Termat e referencës nënshkruhen nga eksperti dhe kryetari i Komisionit.
4. Angazhimi i ekspertit përfundon pas prezantimit të ekspertizës dhe miratimit nga komisioni. Kryetari i Komisionit, pas përfundimit të ekspertizës, e nënshkruan konfirmimin, me të cilin dëshmon se ekspertiza është kryer sipas termave të referencës. Vendimi për angazhimin e ekspertit, termat e referencës dhe konfirmimi për kryerjen e ekspertizës i dorëzohen Divizionit për Buxhet dhe Pagesa për ekzekutimin e pagesës.

#### **Neni 5 Kompensimi buxhetor për ekspertizat e jashtme**

1. Kufiri i mjeteve buxhetore që ndahen për një ekspertizë, përcaktohet nga Komisioni me rastin e marrjes së vendimit për angazhimin e ekspertëve, në vartësi nga vëllimi dhe përmbajtja e lëndës (projektiligj, raport, etj.).
2. Kompensimi financiar, për shërbimin që eksperti ia ofron Komisionit, bëhet në bazë të ditëve të punës, si në vijim:

1-5 ditë pune,	50 € për ditë pune
1-10 ditë punë	40 € për ditë pune
Mbi 10 ditë pune	35 € për ditë pune

3. Mjetet buxhetore, nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, nuk mund të tejkalojnë shumën mbi 800 €, për një ekspertizë.

### **Neni 6 Dëgjimet e komisionit**

Shpenzimet për dëgjimet që organizohen nga komisioni brenda apo jashtë selisë së Kuvendit, mbulohen nga mjetet buxhetore të komisionit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen: pijet, ushqimi dhe në rastet kur dëgjimi mbahet jashtë selisë së Kuvendit, rezervimi i sallës dhe pajisjeve teknike të nevojshme.

### **Neni 7 Aktivitetet mbikëqyrëse të komisionit**

Komisioni shfrytëzon mjetet buxhetore për të mbuluar shpenzimet që ndërlihen me aktivitetet mbikëqyrëse, si: monitorimi i zbatimit të politikave dhe programeve nga ministritë, monitorimi i zbatimit të ligjeve, vizitat në terren me karakter mbikëqyrës, si dhe mbikëqyrja e institucioneve të pavarura. Gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse në kuadër të shpenzimeve përfshihen: pijet, ushqimi, rezervimi i sallës dhe pajisjeve teknike të nevojshme.

### **Neni 8 Grupet punuese kur punojnë jashtë selisë së Kuvendit**

Kur grupet punuese, më miratim të komisionit, vendosin të punojnë jashtë selisë së Kuvendit, nga mjetet buxhetore të komisionit mbulohen shpenzimet për pije dhe ushqim. Në rastet kur punohet më shumë se një ditë, mbulohen edhe shpenzimet për fjetje.

### **Neni 9 Marrëdhëniet ndërparlamentare**

1. Shpenzimet për aktivitetet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërparlamentar më komisionet homologe, të përcaktuara në nenin 74 të Rregullores së Kuvendit, nuk mbulohen nga Buxheti i komisionit.
2. Shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, mbulohen me vendim të Kryesisë së Kuvendit.

### **Neni 10 Arsyetimi i shpenzimeve**

2. Për arsyetimin e shpenzimeve të përcaktuara në nenin 6, 7 dhe 8, të këtij udhëzimi, Koordinatori i Komisionit përgatitë raportin e shpenzimeve të nënshkruar nga



kryetari i Komisionit, të cilit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve me nënshkrime, agenda dhe fatura.

3. Dokumentacioni nga paragrafi 1 i këtij neni, dorëzohet në Divizionin për Buxhet dhe Pagesa, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas përfundimit të aktivitetit.

### **Neni 11** **Bashkëfinancimet**

1. Komisioni mund të kërkoj bashkëfinancim, për të gjitha aktivitetet e përcaktuara në këtë Udhëzim, nga organizatat dhe institucionet që mbështesin punën e Kuvendit.
2. Në rastet e bashkëfinancimit të ekspertizave, organizata që bashkëfinancon, duhet të jap pëlqim për përzgjedhjen e ekspertit dhe përgatitjen e termave të referencës.
3. Termat e referencës nënshkruhen nga kryetari i Komisionit, personi i autorizuar nga organizata/institucioni bashkëfinancues dhe eksperti.
4. Pagesa bëhet sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërsa komisioni e paguan vetëm pjesën e vet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 5 të këtij Udhëzimi.
5. Procedura për financimin e pjesës që mbulohet nga organizatat/institucionet partnere, mund të përcaktohet edhe më Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Kuvendin, dhe jo domosdosmërisht i nënshtrohen procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzim.

### **Neni 12** **Hyrja në fuqi**

2. Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet vendimi i Kryesisë së Kuvendit, Nr. 03-V-259, datë 1 mars 2010, për kompensimin e ekspertëve të jashtëm në komisione parlamentare.

Prishtinë 19 prill 2011

Kryetar i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

## 2. Forma standarde e vendimit për angazhimin e ekspertëve



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

### Legjislatura IV

Në bazë të nenit 62.3 dhe 65.2 të Rregullores së Kuvendit, dhe nenit 4 të Udhëzimit të Kryesisë së Kuvendit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve, si dhe me rekomandim të grupit punues, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, Komisioni për \_\_\_\_\_, merr këtë:

### V E N D I M

1. Z. \_\_\_\_\_ angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm për Projektligjin për \_\_\_\_\_.
2. Ngarkohet grupi punues dhe koordinatori i komisionit, që brenda \_\_\_ ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

Vendimi nr. \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

**Kryetari i Komisionit,**

\_\_\_\_\_

Vendimi i dorëzohet Divizionit për Buxhet dhe Pagesa.

### 3. Forma standarde e termave të referencës



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

#### Legjislatura IV

---

Në bazë të nenit 4 të Udhëzimit të Kryesisë së Kuvendit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve dhe vendimit të komisionit nr. \_\_\_\_ për angazhimin e ekspertit të jashtëm, Komisioni për \_\_\_\_\_, propozon:

#### TERMAT E REFERENCËS

**Lënda:** Ekspertizë për projektligjin për \_\_\_\_\_

**Eksperti:** \_\_\_\_\_

Adresa:

Data e lindjes:

Tel.:

E-mail:

#### I. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit

1. Shqyrtimi dhe analizimi i detajuar i projektligjit dhe ofrimi i rekomandimeve për ndryshim-plotësim.
2. Raporti me rekomandime (ekspertiza) duhet të dorëzohet në grup punues ose komision me shkrim.
3. Raporti (ekspertiza) duhet të prezantohet dhe të mbrohet para grupit punues ose komisionit.
4. Eksperti detyrohet që të marrë pjesë edhe në dëgjimin legjislativ që organizohet nga Komisioni për projektligjin.



## II. Përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni detyrohet t'i ofrojë ekspertit projektligjin dhe të gjitha materialet tjera relevante për zhvillimin e ekspertizës.
2. Ekspertit i mundësohet të marrë pjesë në takimet e grupit punues, vizitat në terren dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me projektligjin.
3. Gjatë përgatitjes së ekspertizës, komisioni ofron informatat dhe sugjerimet e nevojshme me kërkesë të ekspertit.

## III. Kompenzimi financiar për ekspertizën

1. Për kryerjen dhe dorëzimin e ekspertizës, sipas kushteve të përcaktuara në këtë dokument, eksperti kompenzohet me \_\_\_ EURO.
2. Kompenzimi financiar bëhet për \_\_ ditë pune.
3. Kompenzimi financiar për ekspertin bëhet në afatin ligjor nga Divizioni për Buxhet dhe Pagesa.
4. Pagesa bëhet përmes transaksionit bankar.
5. Të gjitha obligimet tatimore dhe të tjera, që aplikohen në lidhje me kontratat për shërbime, do të kryhen sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë.
6. Komisioni nuk mbulon shpenzimet e udhëtimit, shujtave apo mëditjeve për aktivitetet e ekspertit gjatë kryerjes së ekspertizës.

## III. Dorëzimi i ekspertizës në komision

1. Raporti final i ekspertizës me rekomandimet konkrete duhet të dorëzohet me shkrim në komision para datës 00.00.2011.
2. Ekspertiza e dorëzuar në komision, është pronë intelektuale e ekspertit dhe e komisionit, dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera pa autorizimin e palëve.

Palët pajtohet me kushtet e përcaktuara në këtë dokument:

Eksperti

Kryetari i Komisionit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Prishtinë, \_\_\_\_\_ 2011.



## 4. Forma standarde e letrës konfirmuese



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

### Legjislatura IV

**Për:** z. \_\_\_\_\_, Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Pagesa

**Nga:** z. \_\_\_\_\_ Kryetar i Komisionit për \_\_\_\_\_

**Lënda:** Konfirmim për kryerjen e ekspertizës

**Data:** \_\_\_\_\_

Në bazë të vendimit të komisionit nr.\_\_\_\_, për angazhimin e ekspertit të jashtëm, konfirmoj se z.\_\_\_\_\_, e ka përfunduar ekspertizën për projektligjin për \_\_\_\_\_ dhe e ka dorëzuar atë në komision, sipas kushteve dhe afateve kohore të përcaktuara në termat e referencës.

Autorizohet Divizioni për Buxhet dhe Pagesa për ekzekutimin e pagesës në shumën e përcaktuar në termat e referencës dhe sipas procedurave të definuara në dispozitat e Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Të bashkangjitur e gjeni edhe një kopje të ekspertizës të dorëzuar në komision.

**Kryetari i Komisionit,**

\_\_\_\_\_

## 5. Forma standarde e vendimit për angazhimin e ekspertëve – Bashkëfinancimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

### Legjislatura IV

---

Në bazë të nenit 62.3 dhe 65.2 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 4, 5 dhe 11 të Udhëzimit të Kryesisë së Kuvendit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve, si dhe me rekomandim të grupit punues, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, Komisioni për \_\_\_\_\_, merr këtë:

### V E N D I M

3. Z. \_\_\_\_\_ angazhohet si ekspert i jashtëm për Projektligjin \_\_\_\_\_.
4. Ngarkohet grupi punues, koordinatori i komisionit dhe përfaqësuesi i organizatës bashkëfinancuese, që brenda tri (3) ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.
5. Angazhimi i ekspertit të jashtëm bashkëfinancohet nga \_\_\_\_\_ (emri i organizatës bashkëfinancuese), në përputhje me nenin 11 të Udhëzimit të Kryesisë së Kuvendit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Vendimi nr. \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

**Kryetar i Komisionit**  
N/N

\_\_\_\_\_

Vendimi i dorëzohet Divizionit për Buxhet dhe Pagesa.

## 6. Forma standarde e termave të references – Bashkëfinancimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

### Legjislatura IV

Në bazë të nenit 4, 5 dhe 11 të Udhëzimit të Kryesisë së Kuvendit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve dhe vendimit të komisionit nr.\_\_\_\_ për angazhimin e ekspertit të jashtëm, Komisioni për \_\_\_\_\_ propozon:

### TERMAT E REFERENCËS

**Lënda:** \_\_\_\_\_

**Eksperti:** \_\_\_\_\_

Adresa:

Data e lindjes:

Tel.:

E-mail:

#### **I. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit**

5. Shqyrtimi dhe analizimi i detajuar i projektligjit dhe ofrimi i rekomandimeve për ndryshim-plotësim.
6. Raporti me rekomandime (ekspertiza) duhet të dorëzohet në grup punues ose komision me shkrim.
7. Raporti (ekspertiza) duhet të prezantohet dhe të mbrohet para grupit punues ose komisionit.
8. Eksperti obligohet që të marrë pjesë në takimet e grupit punues, nëse i kërkohet. Gjithashtu, nëse i kërkohet, ai duhet të marrë pjesë në dëgjimin legjislativ që organizohet nga Komisioni për projektligjin.

## II. Përgjegjësitë e Komisionit

4. Komisioni obligohet t'i ofroj ekspertit projektligjin dhe të gjitha materialet tjera relevante për zhvillimin e ekspertizës.
5. Ekspertit i mundësohet të marrë pjesë në takimet e grupit punues, vizitat në terren dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me projektligjin.
6. Gjatë përgatitjes së ekspertizës, komisioni ofron informatat dhe sugjerimet e nevojshme me kërkesë të ekspertit.

## III. Kompenzimi financiar për ekspertizën

7. Për kryerjen dhe dorëzimin e ekspertizës, sipas kushteve të përcaktuara në këtë dokument, eksperti kompenzohet me \_\_\_\_ EURO.
8. Kompenzimi financiar bëhet për \_\_\_\_ ditë pune. Nga buxheti i Komisionit do të kompenzohen \_\_\_\_ ditë pune në vlerë \_\_\_\_ euro, ndërsa, pjesën tjetër në vlerë prej \_\_\_\_ euro do ta kompenzoj \_\_\_\_\_ (organizata bashkëfinancuese).
9. Kompenzimi financiar për ekspertin bëhet në afatin ligjor nga Divizioni për Buxhet dhe Pagesa si dhe \_\_\_\_\_ (organizata bashkëfinancuese).
10. Pagesa bëhet përmes transaksionit bankar në llogarinë: \_\_\_\_\_ banka: \_\_\_\_\_.
11. Të gjitha obligimet tatimore dhe të tjera, që aplikohen në lidhje me kontratat për shërbime, do të kryhen sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë.
12. Komisioni nuk mbulon shpenzimet e udhëtimit, shujtave apo mëditjeve për aktivitetet e ekspertit gjatë kryerjes së ekspertizës.

## III. Dorëzimi i ekspertizës në komision

3. Raporti final i ekspertizës me rekomandimet konkrete duhet të dorëzohet me shkrim në komision deri më datën \_\_\_\_\_.
4. Ekspertiza e dorëzuar në komision, është pronë intelektuale e ekspertit dhe e komisionit, dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera pa autorizimin e palëve.

Palët pajtohet me kushtet e përcaktuara në këtë dokument:

Kryetar i Komisionit  
N/N

Eksperti  
N/N

Përfaqësuesi i autorizuar i organizatës bashkëfinancuese

N/N

Prishtinë, \_\_\_\_\_2011



## 7. Forma standarde e letrës konfirmuese – Bashkëfinancimi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

### Legjislatura IV

---

**Për:** z. \_\_\_\_\_, Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Pagesa

**Nga:** z. \_\_\_\_\_ Kryetar i Komisionit për \_\_\_\_\_

**Lënda:** Konfirmim për kryerjen e ekspertizës

**Data:** \_\_\_\_\_

Në bazë të vendimit të komisionit nr.\_\_\_\_, për angazhimin e ekspertit të jashtëm, konfirmoj se z. \_\_\_\_\_, e ka përfunduar ekspertizën për projektligjin për \_\_\_\_\_ dhe e ka dorëzuar atë në komision, sipas kushteve dhe afateve kohore të përcaktuara në termat e referencës.

Autorizohet Divizioni për Buxhet dhe Pagesa për ekzekutimin e pagesës në shumën e përcaktuar në termat e referencës dhe sipas procedurave të definuara në dispozitat e Udhëzimit për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve. Ndërsa, pjesën e pagesës së bashkëfinancuar e paguan organizata bashkëfinancuese në përputhje me termat e referencës.

Të bashkangjitur e gjeni edhe një kopje të ekspertizës të dorëzuar në komision.

**Kryetari i Komisionit,**

\_\_\_\_\_

## 8. Forma standarde e planit vjetor të buxhetit të Komisionit

### Komisioni për ... - Plani vjetor i buxhetit<sup>1</sup>

Muaji	Aktiviteti i Komisionit [Renditur sipas planit të punës]	Përshkrimi i shpenzimit	Shënim	Shuma në Euro
Janar	1 Aktiviteti 1			
	2 Aktiviteti 2			
	3 Aktiviteti 3			
	4 Aktiviteti 4			
	5 Aktiviteti ...			
<b>Nëntotali:</b>				
Shkurt	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
<b>Nëntotali:</b>				
Mars	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
<b>Nëntotali:</b>				
...	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
<b>Nëntotali:</b>				
<b>Nëntotali:</b>				
<b>Totali:</b>				

<sup>1</sup> [Ky plan i bashkangjitet si shtojcë Planit vjetor të punës së Komisionit, i cili mund të miratohet njëkohësisht nga Komisioni].







*Publikimi i këtij doracaku është mundësuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI).*



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA